




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.562/2023

Datë: 27 dhjetor 2023

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 34 par. 1, pika 1.1 i Ligjit 06/L-054 për Gjykatat, si dhe nenit 12 paragrafi 1, i Rregullores Nr. 02/2019 për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga Detyra të Gjyqtarëve Porotë, në vazhdimin e takimit 318-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2023, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Miratohet dorëheqja e z. Heroit Xhemajli, nga detyra e gjyqtarit porot në Gjykatën Themelore Ferizaj– Dega Shtërpçë.
- II. Vendimi hyn në fuqi më 27 dhjetor 2023.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 18 dhjetor 2023, ka pranuar nga Heroit Xhemajli, deklaratën e dorëheqjes nga pozita e gjyqtarit porot në Gjykatën Themelore Ferizaj – Dega në Shtërpçë, për shkak se i njëjti ka filluar në një detyrë të re e cila i'a pa mundëson të bartë edhe detyrën e gjyqtarit porot.

Në takimin e mbajtur më 27 dhjetor 2023, KGJK-ja, pas shqyrtimit të kërkesës së z.Xhemajli, e në bazë të nenit 12.1 pika b) të Rregullores nr. 02/2019 për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga Detyra të Gjyqtarëve, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGA

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Heroit Xhemajli;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore Ferizaj;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Arkivit.